

 NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH. A.
GJP "AUTOBUSKA STANICA" A. D.
MPE "BUS STATION" J. S.

Nr. 02/757 Data 22-04 2021
No. Date

PRISHTINË/A

**NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE
"STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A.
PRISHTINË**

***RAPORTI PËR KOMISIONIN E
AUDITIMIT***

Viti ushtrimor 01.01.2020 deri më 31.12.2020

Prishtinë, Prill 2021

Raporti për Komisionin e Auditimit lidhur me auditimin e Pasqyrave Financiare NPL “Stacioni i Autobusëve” SH. A. për vitin ushtrimor që përfundon me 31.12.2020

Të nderuar,

Në pajtim me kërkesat e nenit 10 të Ligjit Nr 06/L-032 Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim si dhe në pajtim me kërkesat e nenit 10 dhe 11 të Udhëzimit Administrativ Nr 02/2019 Për Pavarësinë e Auditorëve Ligjorë dhe Firmave të Auditimit të lëshuar nga Këshilli Kosovar i Raportimit Financiar (KKRF), lëshojmë këtë Raport Shtesë për Komisionin e Auditimit lidhur me auditimin e Pasqyrave Financiare të ushtrimit 2020 për kompaninë NPL Stavioni i Autobusëve Sh.A. me seli në Prishtinë.

Ne njoftojmë Komisionin e Auditimit se planifikuam dhe kryem auditimin e Pasqyrave Financiare 2020, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, sipas të cilave ne kemi përpiluar Raportin tonë gjatë muajt Prill 2021. Ne vlerësuam mjedisin e kontrollit të brendshëm për të planifikuar procedurat tona të auditimit, për zbatimin e të cilave do ta mbështesim opinionin tonë në lidhje me Pasqyrat Financiare dhe jo për të ofruar siguri të arsyeshme mbi mjedisin e Kontrollit të brendshëm të kompanisë tuaj. Një shqyrtim i tillë nuk do të zbulonte domosdoshmërisht të gjitha çështjet e kontrollit të brendshëm, te cilat mund të jenë dobësi me ndikim material, bazuar në Standardet e themeluara nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve Profesionistë (IFAC).


Disa nga çështjet e ngritura në këtë Raport paraqesin dobësit procedurale në sistemin e kontrollit të brendshëm.

Ne do të donim të përfitonim nga ky rast për ta falenderuar tërë Drejtimin dhe personelin tjetër për bashkpunim korrekt gjatë auditimit tonë.

Synim i këtij Raporti është informimi, shfrytëzimi dhe rekomandimi për ngritjen e efektivitetit dhe efikasitetit nga na e Drejtimin të NPL “Stacioni i Autobusëve” SH. A. dhe nuk është menduar të jetë dhe nuk do të duhej të shfrytëzohej nga askush tjetër përveç palëve të specifikuara.

Ne do të kemi kënaqësinë të diskutojmë komentet dhe rekomandimet tona me Ju dhe nese e shihni të arsyeshme, edhe të marrim pjesë në vënien e tyre në zbatim ose në mbikqyrjen e progresit të cilit do rekomandim.

Me respekt,


Hysen Ramabaja, Partner i Angazhimit



“H&N” Sh.P.K
Rruga “Ilaz Kodra” nr.29
10000 Prishtinë, Kosovë

Kontakti: auditimit@gmail.com,

Tel: 038 / 541 144

15 Prill 2021

TABELA E PËRMBAJTJES

FAQE

Hyrje.....	2
1. Përgjegjësia e Drejtimit për objektivat dhe kufizimet e Kontrollit brendshëm.....	4
2.Konsiderata e përgjithshme.....	5
3.Implementimi i rekomandimeve nga auditimet paraprake.....	6
4.Deklarata e pavarësisë së auditorit.....	6
5.Tarifat e auditimit.....	6
6.Materialiteti.....	6
7.Informata tjera të rëndësishme rreth auditimit.....	6
8.Gjetjet e auditimit.....	7
Deklarata e përgjegjësisë.....	12

*Raporti për Komisionin e Auditimit
(vazhdim)*

1. PËRGJEGJËSIA E MENAXHMENTIT PËR OBJEKTIVAT DHE KUFIZIMET E KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Përgjegjësia e Menaxhmentit

Menaxhmenti është përgjegjës për vendosjen dhe ruajtjen e kontrollit të brendshëm. Në përmbushjen e kësaj përgjegjësie, vlerësimet dhe gjykimet nga menaxhmenti janë të nevojshme për të vlerësuar përfitimet e pritura dhe shpenzimet e ndërlidhura me kontrollet.

Objektivat

Objektivat e kontrollit të brendshëm janë të sigurojë menaxhim më të arsyeshme, por jo absolut, sigurimin që pasuritë janë të mbrojtura nga humbjet e përdorimi të paautorizuar ose dëmtimit, dhe se transaksionet ekzekutohen në përputhje me autorizimin e menaxhmentit dhe regjistrohen në mënyre që të lejojnë përgatitjen e pasqyrave financiare në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Kufizimet

Për shkak të kufizimeve ekzistuese në çdo kontroll të brendshëm, deklarimeve të gabuara për shkak të gabimit ose mashtrimit mund të ndodhin e të mos zbulohen. Gjithashtu parashikimet e çdo vlerësimi të kontrollit të brendshëm për periudhat e ardhshme janë subjekt i rrezikut, për shkak se kontrolli brendshëm mund të bëhet jo i përshtatshëm për shkak të ndryshimeve në kushtet ose shkallën e pajtueshmërisë me politikat apo procedurat mund të përkeqësohen.

*Raporti për Komisionin e Auditimit
(vazhdim)*

2. KONSIDERATA E PËRGJITHSHME

Paraqitja e drejtë e Pasqyrave Financiare

Pasqyrat financiare për periudhën 01.01.2020 deri më 31.12.2020 sipas verifikimeve të bëra dhe opinionit tonë, me përjashtim të asaj që është potencuar në bazën për opinion, pasqyrojnë me drejtësi pozicionin financiar, performancën financiare dhe fluksin monetar të kompanisë NPL “Stacioni i Autobusëve” SH. A. nga Prishtina. Po ashtu, sipas pikëpamjes tonë, këto pasqyra me besnikëri paraqesin efektet e transaksioneve, ngjarjeve dhe kushteve tjera në përputhje me përkufizimet dhe kriteret e njohjes për aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet.

Vijimësia

Pasqyrat financiare janë pregaditë në bazë të vlerësimit se SAP SH.A. edhe përkundër vështërsive të mundëshme afariste, ka aftësinë për të vazhduar aktivitetet e saja afariste në vijimësi.

Kontabilitetit mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara

NPL “Stacioni i Autobusëve” SH. A. ka pregaditë Pasqyrat e saj financiare për vitin 2020 duke përdorë kontabilitetin mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara dhe se zërat kontabël janë njohur si aktive, detyrime, kapital neto, të ardhura dhe shpenzime (elemente të pasqyrave financiare), kur ato kanë plotësuar përkufizimet dhe kriteret për njohjen e këtyre elementeve të dhëna në kuadër, duke veçuar ato elemente ku kemi pasë pasiguri, për të cilat elemente do të shtjellohen më detalisht në shënimet përkatëse.

Qëndrueshmëria e paraqitjes

Paraqitja dhe klasifikimi i zërave në pasqyrat financiare janë mbajtur njëjtë nga njëra periudhë në tjetrën.

Informacionet krahasuese

Pasqyrat financiare të periudhës 01.01.2020 deri më 31.12.2020 për të gjitha shumat e raportuara, japin informacione krahasuese me periudhën paraardhëse.

3. IMPLEMENTIMI I REKOMANDIMEVE NGA AUDITIMET PARAPRAKE

Gjetjet

Testimet tona kanë vërejtur se Oraganet e Ngarkuara me Qeverisjen dhe Drejtimi i kompanisë i kanë kushtuar kujdes implementimit të rekomandimeve nga vitet paraprake dhe kanë implemetuar pothuajse të gjitha rekomandimet e adresuara nga vitet paraprake, me përjashtim atyre që pjesërisht janë në proces, të cilat janë si vijon:

1. Bordi i drejtorëve duhet të siguroj që në afat sa më të shkurtë kohor të plotësohet pozita me zyrtarin e pasurisë si dhe regjistri i pasurive i përmban të gjitha informacionet për secilën pasuri sipas kërkesës së rregullore për menaxhimin e pasurive.

* Zyrtari për pasuri është emeruar por, një regjistër duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël, si dhe neni 6.4 ku kërkohet që Zyrtari Kryesor Ekzekutiv duhet të themeloj regjistër kontabël të pasurive jo financiare ku përveç informatave të kërkuara nga Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë, do të përfshihen edhe këto elemente: emri i ndërmarrjes publike, emri i pasurisë, përshkrimi, numri serik, numri i bar kodit, data e pranimit, lokacioni, kategoria, burimi i financimit, vlera fillestare ose e vlerësuar, zhvlerësimi i vitit të tanishëm dhe zhvlerësimi i akumuluar, vlera në libër, data e tjetërsimit, dhe numri referues i dokumentit të pranimit.

2. Bordi i drejtorëve duhet të sigurojë se me rastin e inventarizimit të asetëve, anëtarët e komisioneve të jenë përgjegjës edhe në përgatitjen e raportit përmbledhës mbi gjendjen e pasurive themelore, pajisjeve dhe inventarit në mënyrë profesionale, objektive dhe në përputhje me dispozitat ligjore.

* Auditori ka vërejtur se: Komisioni ka bërë regjistrimi e pasurive por, neve nuk na është siguruar një raport përmbledhës mbi gjendjen e pasurive themelore, pajisjeve dhe inventarit në mënyrë profesionale, objektive dhe në përputhje me dispozitat ligjore.

3. Bordi i drejtorëve duhet të marrë masa adekuate për përzgjedhjen e zyrtarit të auditimit të brendshëm për të ndihmuar Menaxhmentin lidhur me vlerësimin dhe identifikimin e dobësive të kontroleve të brendshme. Gjithashtu duhet të shqyrtohet mundësia që deri në plotësimin e pozitës, shërbimet e auditimit të brendshëm të sigurohen edhe nga aksionari.

* Bordi ka zgjedhur zyrtarin e auditimit të brendshëm por, pas ankesave nga dy pjesëmarrës në konkurs, IP ka kontestuar rregullsinë e përzgjedhjes, por që komisioni i auditimit është ankuar në vendimin e Inspektoriatit të Punës dhe lënda është ende në procedurë.

4. DEKLARATA E PAVARËSISË SË AUDITORIT

Ne konfirmojmë se sipas njohurive dhe dijenive tona më të mira, kemi vepruar në përputhje me politikat dhe procedurat e firmës, të cilat përfshijnë Seksionin 290 dhe 291 të Kodi i Etikës të IESBA për Kontabilistë profesionistë mbi pavarësinë për Auditimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2020 të SAP Sha-Prishtinë dhe secili pjesëmarrës i firmës “H&N” Shpk në auditim, ka nënshkruar Deklaratën e Pavarësisë.

5. TARIFAT E AUDITIMIT

Tarifat e auditimit të marra nga SAP për vitin 2020 nuk kalojnë 15% të të hyrave të kompanisë audituese “H&N” Shpk nga Prishtina, këtë njoftim për ju e bëjmë sipas kërkesave të UA Nr 2/2019 të KKRF-së;

Raporti për Komisionin e Auditimit (vazhdim)

6. MATERIALITETI

Materialiteti sasior për vitin 2020 është në vlerë 6,665.00 euro (PF të vitit 2020 ka qenë të audituara nga një auditor tjetër dhe nuk kemi informata se sa ka qenë materialiteti). Materialiteti sasior është bazuar në 1% të të Shpenzimeve operative. Ne kemi krahasuar 6 indikator për të caktuar materialitetin si: fitimin/humbjen operative, fitimin/humbjen neto të vitit, ekuitetin, gjithsejtë pasuritë, gjithsejtë të ardhurat dhe gjithsejtë shpenzimet. Nga të gjithë këta indikator, sipas gjykimit tone indikator i shpenzimeve operative ka qenë më i përshtatshmi për të caktuar materialin për vitin 2020;

7. TË DHËNA TJERA RRETH AUDITIMIT

Në pajtim me kërkesat e nenit 10 dhe 11 të Udhëzimit Administrativ Nr 02/2019 Për Pavarësin e Auditorve Ligjor dhe Firmave të Auditimit të lëshuar nga Këshilli Kosovar i Raportimit Financiar (KKRF), ju njoftojmë edhe me këto të dhëna si në vijim:

- Në kryerjen e auditimit marrë pjesë: Nimon Zeneli, Auditor Ligjor dhe Partner i auditimit në kompaninë "H&N" Shpk me një përvojë mbi 35 vjeçare në fushën e kontabilitetit dhe financave si dhe Hysen Ramabaja, Auditor Ligjor, Partner i auditimit dhe Drejtor i kompanisë "H&N" Sh.p.k. me një përvojë mbi 30 vjeçare në fushën e kontabilitetit dhe financave;
- Në këtë auditim nuk kemi angazhuar auditor tjetër jashtë kompanisë audituese "H&N" Sh.p.k. apo ekspertë të jashtëm;
- Ne kemi filluar auditimin së pari me kërkesën për Dokumentacion për fillimin e auditimit me datë 14.12.2020 të përcjellur përmes e-majli dhe kemi mbajtur takim me Zyrtarin Kryesor Financiar të SAP, SH.A. zotri Arianit Grezda dhe zotëri Emin Sylejmani, Menaxher për këtë kontratë, dhe kemi diskutuar lidhur me procesin e auditimit duke potencuar se në këtë takim kemi vlerësuar bashkarisht të dy palët se nuk mund të kryhet auditimi sipas datës së vënë në kontratë nga prokurimi dhe kemi kërkuar zgjatjen e afatit të kontratës. PF nuk ka qenë të aprovuara nga Bordi, dhe po ashtu gjatë auditimit kemi informuar edhe KE z. Luan Hoti, dhe mandej në vijim na është përcjellë dokumentacioni i kërkuar përmes postës elektronike. Mandej sipas pergaditjes së dokumenteve në vijimësi deri më sot, kemi kryer testet substanciale në ambientet e punës në SAP Sh.A.
- Në vijimësi me personat përgjegjës dhe drejtimin kemi komunikuar rreth testimeve tona dhe kërkesën për dokumentacion deri në përfundimin e auditimit;
- Ne kemi bërë këtë shpërndarje të detyrave në kuadër të ekipës së auditimit: Procedurat analitike të PF-ve, testimi i aktiveve afatgjata materiale, parasë së gatshme në bankë dhe arkë, deklarimeve të tvsh-së, të hyrave, pasurive dhe çështje tjera janë kryer nga Nimon Zeneli. Nga Hysen Ramabaja është bërë testimi i të blerjeve, stoqeve, mandej, proceverbaleve të BD, personelit, deklarimit të pagave dhe çështje tjera;
- Sipas Ligjit Nr 06/L-032 Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, Ndërmarrjet publike janë të obliguara të aplikojnë SNRF pa marrë parasysh madhësinë si dhe përpos PF auditori duhet të bëjë edhe auditimin e Raportit vjetor të menaxhmentit.
- Ashtu siç ju kemi informuar në takimin e mbajtur me Ju me datë 20.01.2021 në ambientet e punës së SAP, SHA, gjatë punës tonë nese vërejmë dobësi të bëra bashkarisht që kanë vlerën mbi 6,665.00 euro ne, kualifikojmë opinionin tone;
- Ne nuk kemi vërejtë ndonjë devijim nga drejtimi gjatë përdorjes së metodave të vlerësimit çoftë të pasurive, detyrimeve apo ekuitetit;
- Përgjithësisht dokumentet e kërkuara për auditim të PF-ve nga personat e autorizuar na janë ofruar;

*Raporti për Komisionin e Auditimit
(vazhdim)*

8.GJETJET GJATË AUDITIMIT

8a) Mosprovizionimi dhe moskonfirmimi i llogarive të arkëtueshme dhe të pagueshme tregtare

Gjetjet

Siç është shpalosur në shënimin 7 të pasqyrave financiare përcjellëse, kompania ka prezantuar Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera në PVF-të e vitit 2020, 71,480 €. Për të testuar saktësinë e tyre në kemi kërkuar nga SAP ti dërgojë nëntë letër konfirmime të klientët e Ndërmarrjes, për të konfirmuar vlerën e borxheve të tyre ndaj SAP. Sipas regjistrit kontabël totali i këtyre llogarive të arkëtueshme që kërkuam konfirmimet ishte 43,908.05€, prej tyre në pranuar tri (3) letër konfirmime në shumë prej 11,385.65€, derisa 2 klientë janë në procedurë gjyqësore në shumë prej 11,419.00€ derisa nga kater klientë në vlerë prej 21,103.48€, nuk kemi pranuar konfirmim.

Po ashtu siç është shpalosur në shënimin 11, Llogaritë e pagushme tregtare dhe të tjera në PVF-të të vitit 2020, ishin 30,388.70 €. Për të testuar saktësinë e tyre në kemi kërkuar nga SAP ti dërgojë 9 leter konfirmime të klientet për të bere konfrimimin e llogarive të pagushme në vlerë prej 11,813.24 €. Në kemi pranuar konfirmime nga pesë klientë me vlerë 7,821.32€, ku nga keto konfirmime. te pranua, per dy kliente nuk perputhet gjendaj e karteles financiare me ate te konfirmuar per 461.17 €, derisa nga katër kliente, nuk kemi pranuar konfirmime në vlerë prej 3,530.75€.

Ndikimi

Mungesa e një procedure te brendshme lidhur me provizionimin e llogarive te arketueshme si dhe Moskonfirmimi i gjendjeve e llogarive te arketueshme dhe pagushme paraqet diferenca te mundshme dhe paraqitje te shumave jo te sakta ne paqyrat financiare. Si ne rastin konkret kemi diferenca ne mes gjendjes se llogarive te arketushme te klientet dhe asaj te paraqitura ne karetelat financiare.

Proceset e dobëta të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme nga qiramarrësit rrisin rrezikun që të mos paguajnë tarifat e komunalive dhe të qirasë. Kjo zvogëlon burimin e fondeve të ndërmarrjes dhe rritjen e të arkëtueshmeve dhe të borxheve të këqija. Për më shumë, dhënia me qira e pronave të ndërmarrjes rrit rrezikun e keqpërdorimit, dëmtimit të tyre dhe pengesë në operimin e ndërmarrjes.

Rekomandimi

Menaxhmenti i SAP dhe Personat e ngarkuar me qeverisjen, duhet të siguroi se janë ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme të komunikimit dhe bashkëpunimit me klientët borxhli, në mënyrë që të sigurohen me kohë konfirmimet ndaj auditorit lidhur me vlerën e detyrimeve ndaj NPL Stacioni i Autobusëve Sh.A..

Komenti i Menaxhmentit:

8b). Mosplotësimi i pozitave kryesore te ndërmarrjes

Gjetjet

Bordi nuk ka arrit qe nga data 01.07.2019 te zgjedh Auditorin e Brendshem sipas Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike neni 21 Zgjedhja dhe emerimi i Zyrtarëve të Lartë të NP por, gjatë kesaj periudhe kjo pozite kyqe ka gene vakante deri më 31 mars 2020, kur auditori i brendshem ka nenshkruar kontratën.

Ky vendim është kontestuar nga dy pjesemarre në konkurs duke ushtruar te drejten e ankesës, te cilet jane ankuar në Inspektoriatin e punes, i cili sipas numrit të lëndes nr. 01 Nr. 12-319/2020 dhe shkreses nr.02/2325 15 12 2020, ka konstatuar parregullesi ne perzgjedhje e auditorit te brendshem dhe ka rekomanduar anulimin e konkursit dhe deri ne momentin e perfudnimit te auditimit, nuk ka ndodhe një vendimi i tillë.

Raporti për Komisionin e Auditimit (vazhdim)

Ndikimi

Mos zgjedhja e auditorit të bendshem si nje nder pozitat më me rendesi ne kompani, len hapsire per te deshiruar ne funksionimin efikas dhe efektiv të kontrollit të brendshem.

Po ashtu kontestimi i procesit të perzgjedhjes se auditorit nga Inspektorati i Punes, e zbeh funksionimin e kesaj pozite duke pasur parasysh rendesne që ka AB në kompani dhe rolin e kesaj pozite e cila duhet te jete me integritet, profesionalizem, kompetence profesionale dhe sipas parimit të kodit të etikes.

Rekomandimi

Bordi i Drejtorëve gjegjësisht Komisioni i Auditimit duhet të ushtroj kompetencat sipas Ligjit për Ndermarrjet Publike, duke i ushtruar detyrat dhe Pergjegjesite sipas nenit 18 Mbikqyrja nga Bordi i Drejtorëve, nenit 21 Zgjedhja dhe Emërimi i Zyrtrëve të NP si dhe nenit 25 Funksioni dhe Kompetencat e Komisionit të Auditimit, të do të sigurojë që zyra e auditimit të brendshëm të organizohet dhe të pajiset me personel në mënyrë të rregullt dhe adekuate, dhe rregullisht do të verifikojë përshtatshmërinë dhe funksionimin e rregullt të kësaj zyre , si dhe do të ushtrojë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze mbi Zyrтарin e Auditimit të Brendshëm dhe zyrën e auditimit të brendshëm sipas nentit 25 Funksioni dhe Komptencat e Komisionit të Auditimit;

Komenti i Menaxhmentit:

Sipas vendimit numër 02/550 të datës 30.06.2016 të Ndërmarrjes Publike Lokale Stacioni i Autobusëve SHA, i është vazhduar kontrata e punës Zyrtares së Auditimit të Brendshëm znj. Sarandë Sadriu Mehmeti nga data 01.07.2016 deri më 01.07.2019, prandaj zyrtarisht NPL Stacioni i Autobusëve Prishtinë SHA, ka genë pa mbulueshmëri në këtë pozitë të lartë deri në Mars 2020.

Provë: Vendimi 02/550 i datës 30.06.2016

Komisioni i Auditimit dhe Bordi i Drejtorëve, kanë adresuar dy ankesa në përgjigje dhe kundërshtim të vendimit të Inspektoratit të punës me datë 21.12.2021 me vulë protokollit të Inspektoratit të Punës 6211 dhe 6212 ku ndër të tjera sqarohet paafatshmëria ligjore e këtyre ankesave të kandidatëve, ndërsa sipas afateve ligjore koha për kthimin e përgjigjeve nga IP tashmë ka skaduar gjithashtu.

Provë: Dy ankesat e protokolluara në Inspektoratin e Punës me datë 21.12.2020 dhe me numër protokollit 6211 dhe 6212.

8c) Menaxhimi i pronave

Gjetjet

Nga patundshmëria NPL "Stacioni i Autobusëve" SH. A. Prishtinë, për vitin 2020 është vërejtë se ka probleme në menaxhim dhe në inkasime të të hyrave, ku vërehet nga numri i disa lëndëve të dërguara në gjykata apo te përmbaruesi privat. Sipas Rregullores për menaxhimin e pasurisë jo financiare, mjeteve themelore, aseteve të NPL-së, nenit 6.1, çdo organizatë duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël, si dhe neni 6.4 Zyrtari Kryesor Ekzekutiv duhet të themeloj regjister kontabël të pasurive jo financiare ku përveç informatave të kërkuara nga Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive, do të përfshihen edhe këto elemente: emri i

Raporti për Komisionin e Auditimit (vazhdim)

ndërmarrjes publike, emri i pasurisë, përshkrimi, numri serik, numri i bar kodit, data e pranimit, lokacioni, kategoria, burimi i financimit, vlera fillestare ose e vlerësuar, zhvlerësimi i vitit të tanishëm dhe zhvlerësimi i akumuluar, vlera në libër, data e tjetërsimit, dhe numri referues i dokumentit të pranimit.

Ndikimi

Mos kryerja e regjistrimeve në plotesi sipas kërkesave ligjor, ndikon që kompani mos të identifikojë dhe verifikojnë ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit dhe ky inventarizim pastaj duhet të brazohet me librat kontabel.

Rekomandimi

Menaxhmenti i kompanise duhet të siguroj që të jete në ploteni me kërkesat e Ligjit Nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, neni 12.1 kërkon që shoqëritë tregtare të verifikojnë të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmime mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit, dhe ky inventarizim duhet të barazohet me librat kontabël. Po ashtu, edhe rregullorja për menaxhimin e pasurive financiare neni 18 parasheh formimin e komisionit për inventarizimin e pasurive.

Komisionin për regjistrim të mjeteve themelore, (aseteve) pajisjeve inventarit dhe depos për vitin afarist 2020 - Ky komision është përgjegjës që të hartoj edhe një raport përfundimtarë mbi gjendjen e asetëve të ndërmarrjes. Mirëpo komisioni nuk kishte përgatitur një raport përmbledhës mbi verifikimin dhe gjendjen e pasurive të ndërmarrjes. Kjo për shkak të neglizhencës së komisionit për regjistrimin e mjeteve themelore.

Komenti i Menaxhmentit:

8d).Burimet njerezore

Gjetja

*Nga mostrat e kontrolluar është vërejtur se ka mangësi si në vijim:
Dosjet e auditimit nuk përmbajne nje liste lidhur me kërkesen e dokumenteve te nevojshme se cilat dokumentet duhet ti përmbaje dosja e personelti.*

*Vlerësimi i performanes të punonjësve, nuk gjendet ne te gjitha dosjet e te punesuarve,
Ne dosje nuk kane te gjithë te punesuarit certifikata të kontrollit mjekësor te punonjesve,
Nuk ka certifikata nga gjykata se nuk jane nen hetime*

Ndikimi

Mangesia e dokumentacionit te nevojshem ne dosjet e personelit len hapsire per mos menaxhim e ketyre burimev qe jane primare ne krijimin e te hyrave, si dhe len mundesin e denimeve apo gjaobave ne rast te kontrollit te autoritetebe shteterore, per shkak mungeses se dokumenteve ne dosje.

Rekomandmin

Menaxhmenti per te siguruar se çdo gjë eshte ne rregull nevojitet qe të hartohet nje liste përmbajtësore per dojsen e personelit ne menyre qe menaxhimi dhe kompletimi do te jete shume lehte e menaxhueshme dhe dosjet do te plotesohen me dokumentet e nevojshme sipas kërkesave ligjore.

Komenti i Menaxhmentit:

Raporti për Komisionin e Auditimit
(vazhdim)

8e). Raporti vjetor i menaxhmentit

Sipas Ligjit Nr 06/L-032 Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, Ndërmarrjet publike janë të obliguara të aplikojnë SNRF pa marrë parasysh madhësinë si dhe përpos PF auditori duhet të bëjë edhe auditimin e Raportit vjetor të menaxhmentit..

Gjate fazës së pranimit dhe analizimit te komenteve kemi pranuar edhe raportin final te menaxhmentit.

**Raporti për Komisionin e Auditimit
(vazhdim)**

Deklarata e përgjegjësive

Kjo Letër përfshinë rekomandime për përmirësimin e procedurave të kontroleve të brendshme dhe aspekte të tjera të Kompanisë suaj që rrjedhin nga auditimi jonë. Ne theksojmë se shqyrtimi ynë në Kompani i sistemit të kontrollit të brendshëm financiar është bërë vetëm në lidhje me auditimin tonë sa i përket përgjegjësive tona sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Ne bëjmë këto rekomandime në kuadër të auditimit tonë, por ato në asnjë mënyrë nuk modifikojnë opinionin tonë të auditimit lidhur me pasqyrat financiare si tërësi.

Ne e shikojmë këtë Letër si pjesë e shërbimit tonë për ju, për përdorim të Drejtimit për qëllime të përmirësimit të qeverisjes së Kompanisë.

Kufizimet e rishikimit tonë

Çështjet e ngritura në këtë Letër janë vetëm ato të cilat erdhen në vëmendjen tonë gjatë punës sonë të auditimit dhe nuk janë domosdoshmërisht një deklaratë e plotë e të gjitha dobësive që ekzistojnë ose të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen. Rekomandimet për përmirësime duhet të vlerësohen nga ju për ndikimin e tyre të plotë para se ata të jenë zbatuar. Klasifikimet e gjetjeve tona janë përfunduar në bashkëpunimin me Drejtimin me qëllimin e përshkruar në të, dhe janë prodhuar vetëm si një tregues i përgjithshëm i rëndësisë së çështjes, se sa si një fakt përfundimtar në lidhje me ndikimin e mundshëm.

Ky Letër është përgatitur vetëm për përdorimin tuaj si Drejtim dhe nuk duhet cituar në tërësi ose në pjesë, pa pëlqimin tonë paraprak me shkrim.

Sinqerisht ju deshirojmë që edhe në të ardhmen të ushtroni veprimtarinë afariste me suksese edhe ma të mëdha dhe të mos keni anomali në evidenca dhe procedura qofshin ato edhe jo materiale dhe të pa përfillshme.

Me shumë respekt nga ekipa audituese.

Kompania e licencuar audituese "H&N" Sh.P.K.

15 Prill 2021

Prishtinë

Anëtarët e komisionit të auditimit të NPL "Stacioni I Autobusëve" SH.A. Prishtinë,

1. Fatmir Miftari – Kryetar I komisionit



2. Anita Morina – Saraci - Anëtar I komisionit



3. Aferdita Syla – Ismajli - Anëtar I komisionit